



Datë: 11.08.2025
Numër Protokolli: 5446/2025

A.nr.1332/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, më Hava Fekaj, Zyrtare e Lartë për Inspektim Administrativ, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.1332/2025, të datës 09.07.2025, të parashtruar nga ankuesja L.C, kundër organit të punësimit: Komunës së Pejës, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.08.2025, me shumicë vota, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.1332/2025, të datës 09.07.2025, të parashtruar nga ankuesja L.C.

A r s y e t i m

Ankuesja L.C (*tutje referuar vetëm ankuesja*), më datë 09.07.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Përgjigjes në kërkesë të datës 27.05.2025 të Zyrës së Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Pejës, për shkak të mos lëshimit të akt Emërimit, sipas klasës së pagës 4.9, profesional 2, të paraparë më Katalogun e Vendeve të punës për shërbimin Civil dhe mos realizimin të pagës në përputhje me klasën e pagës 4.9, të paraparë më katalogun e Vendeve të punës për Shërbimin Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 14.07.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Pejës, ndërsa kjo e fundit më datë 29.07.2025 ka përcjellë fare përgjigje në ankesë.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe referuar pretendimeve ankimore të parashtruara nga ankuesit, ka gjetur se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë së ankuesja sipas Akt Emërimit me Nr.01-112-72 të datës 04.01.2012, është i punësuar në pozitën e punës Zyrtare e Z.K.GJ.C, në Drejtorinë e Administratës në Komunë e Pejës.

Tutje ankuesja më datë 27.05.2025, ka parashtruar një kërkesë tek Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Pejës, me të cilën ka kërkuar ndryshimin e akt emërimit përkatësisht koeficientit nga profesional 3 në profesion 2 sipas katalogut të vendeve të punës në shërbimin civil. U.D Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore i Komunës së Pejës më datë 25.06.2025, i është përgjigjur ankuesin në kërkesën e tij, duke e njoftuar se është formuar grupi punues për hartimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, është përgatitur drafti final, jemi në fazën e dëgjimit publik dhe më pas miratimin në Kuvendin Komuna, andaj me miratimin e rregullores përkatëse Zyrtare e ZKGJC-ve që kanë kualifikim universitar (së paku bachelor) do të kenë koeficient si profesional 2.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon së po i mohohet e drejta për të realizuar koeficientin sipas klasës profesional 2 të përcaktuar për këtë pozitë sipas katalogut të vendeve të punës në shërbimin civil. Kërkon që të aprovohet ankesa, të obligohet Komuna e Pejës respektivisht Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të bëjë ndryshimin e akti emërimit sipas klasës profesional 2 dhe të bëjë kompensimin e diferencës së pagës në mënyrë retroaktive nga data e hyrjes në fuqi të katalogut të vendeve të punës në shërbimin civil.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2, paragrafi 1, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: *”1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj”, dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.*

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës, ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Komuna e Pejës, deri në parashtrimin e ankesës nga ana e ankueses nuk e kishte përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procedimi i pozitës së ankueses në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tij të punës, në kuptim të ligjit

material, gjegjësisht Ligjit përkatës për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores përkatëse për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i zbatimit të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Kosovës lidhur me ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve me qëllim të llogaritjes së pagës bazë dhe duke qenë se nuk kishte përfunduar klasifikimin e vendeve të punës sikurse përcaktohet me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, e aplikueshme nga data 28.02.2024, rrjedhimisht me nenin 34 të kësaj rregullore përcaktohet se: ***Obligohen institucionet në fushën e veprimit të kësaj Rregulloreje të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitive të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se tre (3) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje***, dhe po ashtu, edhe me Vendimin me Nr.08/226, të datës 23.10.2024, të Qeverisë së Republikës së Kosovës për miratimin e Katalogut të Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, më pikën 2 të këtij vendimi është përcaktuar se: *Obligohen të gjitha institucionet që të përfundojnë Klasifikimin e vendeve të punës në përputhje me Rregulloren Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës dhe këtë katalog*, ndërsa, më pikën 3 është shfuqizuar pika 3 dhe 4, e Vendimit Nr. 04/128, të datës 16 shkurt 2023 të Qeverisë së Kosovës, pika këto që i referoheshin detyrimit të Ministrisë së Financave/Thesarit të Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme/Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik për ekuivalentim të koeficienteve dhe korrigjimeve.

Mirëpo duke marr parasysh faktin se sipas përgjigjes në kërkesë të datës 25.06.2025 të u.d Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Pejës, kjo komunë është në fazën e miratimit të Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, rrjedhimisht duke qenë se organi përkatës i punësimit në këtë rast Komuna e Pejës, është në fazën e procesit të klasifikimit të vendeve të punës në administratën komunale e që nënkupton edhe klasifikimin edhe të pozitës së ankuses, atëherë Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e parashtruar nga ankuesja, për klasifikimin e pozitës së saj sipas kategorisë profesionale 2, është e parakohshme, dhe si e tillë, në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritore, e për rrjedhojë, e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitive të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës së theksuar më lart, ankuses do t'i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankesës për klasifikimin e pozitës së saj të punës.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1332/2025

Hava FEKAJ

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses L.C;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Pejës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.